



Data	
Nr. Prot	

**RELACION**

**PËR**

**PROJEKTVEEDIMIN**

**PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË SELENICË, ME  
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË “AGRARE  
AMBJENTALISTE TË SHQIPËRISË”, Z. IDAI NAZMI VEIZAJ**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregullator ose Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Me shkresën nr. 1735/2 prot., datë 6.10.2023, Këshilli i Bashkisë Selenicë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Lavdie Agim Maraj, propozuar nga subjekti politik “Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë”.

Referuar nenit 164, paragrafi 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Agrare Ambjentaliste të Shqipërisë për Këshillin e Bashkisë Selenicë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 3, z. Idai Nazmi Veizaj.

Me shkresën nr. 372, prot., datë 6.2.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Selenicë, z. Idai Nazmi Veizaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Këshillin Bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër VL-P.A.A-18197/1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Idai Nazmi Veizaj., rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, me shkresën nr.125 prot., datë 16.01.2024 ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr.124 prot., datë 16.01.2024 ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për z. Idai Nazmi Veizaj.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Idai Nazmi Veizaj, në Këshillin e Bashkisë Selenicë.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Idai Nazmi Veizaj, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Idai Nazmi Veizaj, në Këshillin e Bashkisë Selenicë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

**Jona JOSIFI** - Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

**Majlinda ÇELMETA** - Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

**Ylli MERKAJ** - Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË SELENICË, ME  
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË “AGRARE  
AMBJENTALISTE TË SHQIPËRISË”, Z. IDAI NAZMI VEIZAJ**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1735/2 prot., datë 6.10.2023, Këshilli i Bashkisë Selenicë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Lavdie Agim Maraj, propozuar nga subjekti politik “Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë”.

Referuar nenit 164, paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Agrare Ambjentaliste të Shqipërisë për Këshillin e Bashkisë Selenicë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 3, z. Idai Nazmi Veizaj.

Me shkresën nr. 372, prot., datë 6.2.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Selenicë, z. Idai Nazmi Veizaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Këshillin Bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër VL-P.A.A-18197/1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Data: dd mm vvvv Nr:  
Ora: hh:mm



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Selenicë me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Agrare Ambjentaliste të Shqipërisë, z.Idai Nazmi Veizaj”

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Idai Nazmi Veizaj., rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, me shkresën nr.125 prot., datë 16.01.2024 ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr.124 prot., datë 16.01.2024 ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për z. Idai Nazmi Veizaj.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Idai Nazmi Veizaj, në Këshillin e Bashkisë Selenicë.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Idai Nazmi Veizaj, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z Idai Nazmi Veizaj,në Këshillin e Bashkisë Selenicë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

### **V E N D O S:**

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Selenicë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Agrare Ambientaliste të Shqipërisë, z. Idai Nazmi Veizaj.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Iirjan CELIBASHI**

Data: dd mm vvvv Nr:  
Ora: hh:mm



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Selenicë me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Agrare Ambientaliste të Shqipërisë, z.Idai Nazmi Veizaj”

Data: dd mm vvvv Nr:  
Ora: hh:mm



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Selenicë me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Agrare Ambientaliste të Shqipërisë, z.Idai Nazmi Veizaj”